

Noftim për vend pune si “**Inspektori i Strukturës Mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike**”

Bordi i Mbikëqyrjes Publike njofton vend të lirë pune në pozicionin “Inspektori i Strukturës Mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”. Kandidati duhet të plotësojë kriteret si në vijim:

- a. Të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
- b. Të ketë zotësi për të vepruar;
- c. Të ketë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në profilet auditim, kontabilitet ose financë, si dhe të ketë jo më pak se 10 vite përvojë pune të përgjithshme në fushën e auditimit ligjor dhe të raportimit financiar, kombinuar me trajnime specifike për dhënien e sigurisë së cilësisë. Nëse trajnimet konsiderohen të pamjaftueshme ato duhet të kryhen brenda dy viteve nga momenti i lidhjes së kontratës së punës;
- ç. Të mos ushtrojë profesionin e audituesit ligjor dhe të mos jetë i punësuar apo i angazhuar me një auditues ligjor ose shoqëri auditimi;
- d. Të mos jenë marrë ndaj tij/saj masa disiplinore të largimit nga puna për shkak të një shkelje të rëndë disiplinore;
- dh. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë;
- e. Të zotërojë gjuhën Angleze në nivel të pranueshëm dhe të përshtatshëm për punën.

Kandidati të shprehë interes brenda datës **3 shtator 2018** në adresën info@bmp.al